

SHKALLËT E BESIMTARËVE NË RRUGËTIMIN DREJT ALLAHUT (MEDAARIXH ES-SAALIKIIN)

Lënia e çështjes në dorë të Allahut / *et-Tefwiid* /

التَّفْوِيضُ

Dr. Hatim el-Haxh

Materiali është përmbledhje e kuptimeve të audio-ligjëratës nga nxënësit e hoxhës

<https://buff.ly/2hbVv4T>

Allahu ﷻ thotë ndërsa citon besimtarin nga familja e Faraonit:

"وَأَفْوِضْ أَمْرِي إِلَى اللَّهِ إِنَّ اللَّهَ بَصِيرٌ بِالْعِبَادِ"

"... çështjen time ia lë në dorë Allahut. Vërtet Allahu sheh robërit." (el-Gaafir, 44)

Lënia e çështjes në dorë të Allahut (*tefwiid*)¹ ka kuptim më të hollë dhe më përfshirës sesa mbështetja në Të (*tewekku*), meqë mbështetja ndodh pas angazhimit në shkaqe, kurse lënia e çështjes në dorë bëhet para dhe pas angazhimit në shkaqe. Lënia e çështjes në dorë të Allahut është thelbi i dorëzimit ndaj Allahut (*istislaam*), ndërsa mbështetja në Të është një degë² e *istislaam*. Kjo ka tri nivele:

¹ Lënia në dorë e çështjes zakonisht përdoret në kontekstin e dhënies në dorëzim të çështjes një ortaku ose një ndihmësi. Këtu, kjo nënkupton t'i lësh në dorë çështjen Zotit të të gjitha gjërave. Kur personi bën këtë, nuk bën të shqetësohet më për çështjen. Kjo nënkupton të luturit e Allahut për udhëzim dhe të kërkojmë prej Tij të bëjë plane në favor tonin, të na tregojë rrugën dhe të na bartë përgjatë saj, jo vetëm të na ndihmojë ta marrim një rrugë që tashmë kemi përzgjedhur.

² Imam el-Harawi po lë të nënkuptohet se mbështetja te Allahu (*tewekku*) do të thotë që robi ka vendosur dhe është angazhuar në shkaqe, kurse lënia e çështjes në dorë të Tij (*tefwiid*) do të thotë që robi mohon çfarëdo ndikimi (*hawl*) apo fuqie (*kuweh*) nga ana e vet dhe i dorëzon krejtësisht çështjen e vet Allahut për të vendosur për të. Imam Ibn el-Kajjim në *Medaarixh* nuk pajtohet me mësuesin e tij (Imam el-Harawin) dhe argumenton në favor të shkallës apo stacionit të *tewekkulit*. Ai citon ajete nga Kurani, ku Allahu urdhëron të Dërguarin e Tij të mbështetet te Ai dhe ta marrë Atë për *wekiil* (rregullues të çështjeve). Ai argumenton se, kurse mbështetja te Allahu përmendet aq shumë në Kuran në kontekste të ndryshme, lënia e çështjes në dorë të Tij (*tefwiid*) përmendet vetëm një herë ndërsa citohet besimtari i familjes së Faraonit. Ai po ashtu argumenton se i Dërguari i Allahut u quajt el-Mutewekkil nga vetë Allahu, siç përcolli el-Buhari nga Abdullah ibn Amr, i cili tha: "Ajete 'Vërtet Ne të dërguam (O Muhamed) si një dëshmitar, si një përgëzues dhe si një paralajmërues' (48:8), që

Niveli i parë është që para çfarëdo veprimi të dish se ti s'ke kurrfarë fuqie, kështu që:

- S'guxon të ndihesh i sigurt nga planet³ (e Allahut)
- S'bën ta humbësh shpresën në ndihmën e Tij⁴
- S'bën të mbështetesh te nijeti që ke⁵

Niveli i dytë është të parët e pashmangshmërisë së fatit, në mënyrë që:

- Të mos shohësh shpëtim në asnjë nga veprimet e tua⁶
- Të mos shohësh shkatërrimin në asnjë gjynah⁷

gjendet në Kuran, është edhe në Tewrat në formën: 'Vërtet Ne të dërguam (O Muhamed) si një dëshmitar, si një përgëzues dhe si një paralajmërues, si edhe si një mbrojtje për të pamësuarit. Ti je rob i Im dhe pejgamberi Im, dhe Unë ta kam vënë emrin el-Mutewekkil.'

Imam Ibn el-Kajjim argumenton se mbështetja e plotë në Allahun përfshin në vete edhe lënien e çështjes në dorë të Tij. Mbështetja nuk ndodh vetëm pasi të angazhohesh në shkaqe; ajo ndodh para angazhimit, gjatë angazhimit dhe pas angazhimit. Pozitën e Ibn el-Kajjimit mund ta përforcosh me thënien e Allahut drejtuar të Dërguarit të Tij në suren et-Teubeh: "Kurrë nuk do të goditemi nga ndonjë gjë, përveç nga ajo që caktoi Allahu për ne. Ai është mbrojtësi ynë (Mewlaana). Dhe vetëm Allahut le t'i mbështeten (të bëjnë *tewekkul*) besimtarët."

Ndërsa lënia e çështjes në dorë të Allahut mund të jetë pjesë e mbështetjes së plotë te Ai, theksimi i domethënies së saj është i rëndësishëm që njerëzve të mos u mungojë të kuptuarit dhe zbatimi i mbështetjes. Kjo ka rëndësi të veçantë për njerëzit që kanë zemrat të lidhura me shkaqe, që kanë probleme me ankth, me nervozë, me entuziazëm, madje dhe me shkelje për të arritur atë që ata besojnë se është e dobishme për vetë ata, për komunitetin apo për popullin.

³ Sikur njeriu inteligjent, i fortë e i pushtetshëm të dinte se, në të vërtetë, nuk posedon kurrfarë force a pushteti dhe tërë fuqia i takon Allahut, planifikuesit më të mirë, kurrë nuk do të ndihej i sigurt nga planet e Tij.

⁴ Sikur i dobëti ta dinte se tërë fuqia i takon Zotit të tij, kurrë s'do të humbte shpresën në ndihmën e Tij.

⁵ Edhe nëse nijetin e ke të pastër dhe vendos të bësh atë që është mirë, prapëseprapë nuk bën të mbështetesh te nijeti yt, sepse Allahu mund ta ndryshojë atë apo ta ndryshojë vendosmërinë tënde duke e shteruar.

⁶ Sepse, ndërsa veprat e mira janë një mjet për të arritur kënaqjen e Tij, shpëtimin e fitojmë me anë të (*el-fadl*) dashamirisë së Tij.

⁷ Sepse, ndërsa e keqja është një mjet që tërheq pakënaqësinë e Tij, falja e Tij është gjithmonë aty për të penduarin; dhe mëshira e Tij përfshin të gjitha gjërat dhe i paraprin hidhërimin të Tij.

- Të mos shohësh ndikim (rezultat) në asnjë shkak⁸

Niveli i tretë ka të bëjë me:

- Të parët e (teuhidit) njësisë së të Vërtetit në kontrollin e plotë që Ai ka mbi lëvizshmërinë dhe palëvizshmërinë, mbi dhënien dhe mosdhënien⁹
- Njohjen e administrimit të duhur (të çështjeve tua) në gjendjet e shumta (*tefrikah*) dhe në bashkimin / shoqërimin me të Vetmin (*xhem'*).¹⁰

⁸ Allahu bëri që shkaqet të çojnë në rezultate të caktuara. Ne duhet ta kemi parasysh këtë, kur të angazhohemi në shkaqe. Mirëpo, njëherësh duhet të jemi të bindur dhe zemrat t'i kemi plotësisht të sigurta se është Ai që lejon shkaqet t'i arrijnë ato rezultate; është Ai që do të mund ta ndalte prerjen e thikës apo djegien e zjarrit, për shembull.

⁹ Në këtë shkallë, kërkuesi nuk sheh veten dhe veprimet e veta, por sheh Allahun, cilësitë e veprimet e Tij, përfshirë dhe njësinë e Tij në krijim (*khalk*), në pronësi (*mulk*), dhe në rregullimin e çështjeve (*tedbiir*) të tërë çfarë ekziston. Ai nuk mori ndokënd për ortak a ndihmës.

¹⁰ Ti duhet të jesh i vetëdijshëm për *xhem'* dhe *ferk* në kuptimin se duhet të shohësh shumësi nga këndvështrimi yt, meqë ajo çfarë do Allahu nga ne dallon sipas rrethanave në të cilat gjendemi. Për shembull, ti duhet t'i dallosh urdhrat dhe ndalimet e Tij nga vendimet që Ai pëlqen (siç është besimi i besimtarëve) dhe vendimet që Ai nuk pëlqen (siç është mohimi i mosbesimtarëve). Të vëresh *ferk* (variacionet, dallimet, ndryshimet, shumësinë) në gjërat është thelbësore ndërsa njeh njësinë e origjinës, krijuesin, pronarin, kontrolluesin, dhe angazhohesh në (*xhem'*) bashkimin / shoqërimin tënd me Të. Të parët e këtyre dallimeve do të ta mundësojë të ngrihesh në nivelin më të lartë të robërimit (*ubudijeh*), kur synimi yt më i lartë nuk është ajo çfarë do ti nga Zoti, por ajo çfarë Ai do nga ti. Kështu, intimiteti ngushëllues (*uns*) që ti ndien gjatë *dhikrit* (kujtimit / përmendjes së Allahut) nuk do të të parandalojë të shkosh në xhami që ta falësh namazin me xhemat, t'i shërbesh mysafirrit, t'i përmbushësh nevojat e familjes sate, etj. Ti bën tërë këtë, sepse kjo është ajo çfarë Ai do nga ti në këto rrethana.